



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljena/Pridata Received/Delivety	23.03.2023	702	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPMVSHCK	2942/2023		113	



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.363/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, me rastin e ankesës me numër A.nr.363/2023 të datës 16.02.2023 e parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit/Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike “masë disiplinore” duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 23.03.2023, mori këtë:

### V E N D I M

**PËRFUNDON** procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.363/2023 të datës 16.02.2023 e parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës sipas Akt emërimit të fundi me numër AE.Nr.01/2022 të datës 14.12.2022 në pozitën “Drejtor i Departamentit Rajonal-Ferizaj”, me datën 16.01.2023 Komisioni Disiplinor në Administratën Tatimore të Kosovës ka nxjerrë Vendimin Nr.Prot.01 sipas të cilit të njëjtin e ka gjetur përgjegjës në procedurë administrative për shkelje të rëndë disiplinore dhe i ka shqiptuar masën disiplinore “Ndalim i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu ndalimin e rritjes në shkallën e pagës për një periudhë tre (3) vjeçare.

I pakënaqur me Vendimin Nr.01 të datës 16.01.2023 e Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës, ankuesi me datën 16.02.2023 përmes e-mailit zyrtar [ankesa.kpmshck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gov.net) ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1846/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se ky vendim është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore për shkak se nuk janë aplikuar fare ose nuk janë

aplikuar drejtë dispozitat ligjore në këtë rast, nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës administrative, nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike dhe nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 24.02.2023, përmes shkresës me numër protokollit 2104/2023 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datën 10.03.2023, përmes shkresës me numër 2557/2023 ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankuesit

**është bërë i pamundur, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se ankuesi me datën 16.02.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa me datën 22.03.2023, ka parashtruar shkresën zyrtare me numër të protokollit 2877/2023, me të cilën ka deklaruar se e tërheq ankesën e datës 16.02.2023. Kolegji i Këshillit në bazë të kësaj rrethane, konstaton se kërkesa për tërheqje të ankesës është e drejtë e palës e përcaktuar me dispozitat e nenit 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, andaj në këtë kuptim, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda, A.nr.363/2023, datë 23/03/2023

Ardita Percuku-Shyti

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit;
- Drejtorit të Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

